

## **Hapet thirrja për bursa shkëmbimi për studime në kuadër të Programit Erasmus + për studentët e UT-së në Universitetin e Ekonomisë Varna, Bullgari.**

Në kuadër të Programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës për semestrin e dytë të vitit akademik 2017-2018 në Universitetin e Ekonomisë Varna, Bullgari.

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

-Shkëmbimin e studentëve për studime;

### **Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- Bachelor;

### **Kohëzgjatja e bursave:**

- Bachelor (4 muaj);

### **Fushat e studimit:**

Për t'u njohur me programin e studimit në gjuhën angleze të ofruar nga Universiteti i Ekonomisë Varna klikoni në adresën:

<http://international.ue-varna.bg/en/45/>

Programi në gjuhën bullgare: <http://international.ue-varna.bg/en/8/bachelor-programmes>

Guida e përgjithshme për studentët klikoni: <http://international.ue-varna.bg/admin/uploads/files/Guidebook%20Incoming%20Students%202017-2018.pdf>

### **Bursat përfshijnë:**

-Kompensimin mujor për studentët (750 EUR në muaj);

-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës);

DISTANCA E UDHËTIMIT ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Bachelor:**

- CV (në gjuhën angleze/ bullgare sipas programit të studimit);
- Kopje e Pasaportës;
- Lista e notave për nivelin Bachelor (e përkthyer në anglisht/bullgarisht sipas programit të studimit);
- Vërtetim studentit (i përkthyer në anglisht/bullgarisht sipas programit të studimit);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze/bullgare sipas programit të studimit);
- Certifikatë e gjuhës së huaj (niveli B2);
- \*Dokumenti Learning Agreement;

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Before Mobility". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës ndërsa në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Ekonomisë Varna lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo për arsye që*

*lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.*

*Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, nga koordinatori akademik në nivel Fakulteti, më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus + Z. Elton Skendaj.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën: [http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning\\_Agreement.pdf](http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf)*

**Afati për aplikim:** 01 Nëntor 2017

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al) me subjekt: “Aplikim për bursë në Universitetin e Ekonomisë Varna, emrin dhe mbiemrin tuaj”.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!